



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 21675 prot.

Shkodër, me 23.10.2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin: "Për miratim shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr. 76 datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar".

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. _____ prot.

Shkodër, me _____.2025

PROJEKT-VENDIMI

Nr. _____, datë _____.2025

“Për miratim shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr. 76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar”.

Këshilli i Bashkisë Shkodër, sot me datë _____.2025 në mbështetje të nenit 35, pika 1, germa “d”, neni 54 germa ‘dh’ të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; të nenit 20, pika 1 dhe 5, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar; Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligji nr. 115/2024, datë 03.12.2024 ‘Për buxhetin e vitit 2025, i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, Udhëzimi Plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 10, datë 12.7.2024 “Për regjistrimin, perdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare”, Ligji nr. 8/2024 për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit Evropian, i cili përfaqëson Bashkimin Evropian, për programin e bashkëpunimit (Interreg VI-A) IPA Itali-Shqipëri-Mali i Zi (Adriatiku Jugor) 2021-2027, Marrëveshje Financimi ndërmjet Komisionit Evropian, i cili përfaqëson Bashkimin Evropian, Republikës së Italisë dhe Republikës së Shqipërisë, për programin e bashkëpunimit “(Interreg VI-A) IPA Itali-Shqipëri-Mali i Zi (Adriatiku Jugor)” 2021-2027 CCI 2021TC16IPCB008, Marrëveshjes së Partneritetit datë 20/08/2025, të nënshkruar nga Bashkia Shkodër në cilësinë e partnerit. VKB nr. 76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2025 dhe programin afatmesëm përfundimtar 2025-2027”, i ndryshuar, sipas materialit të përgatitur nga administrata e Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I

1. Miratimin e shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projektin “Territory” me burim financimi donacion, financuar në kuadër të programit të bashkëpunimit (Interreg VI-A) IPA Itali-Shqipëri-Mali i Zi (Adriatiku Jugor) 2021-2027, dhe do të zbatohet me llogari

thesari të plotë. Projekti ka një afat zbatimi 30 muaj nga hyrja në fuqi të marrëveshjes dhe do të përfshihet në programin P.AB141: Siguria Publike dhe Mbrojtja civile.

2. Vlera totale e financimit është **112,786.94 euro**, e konvertuar në lek në shumën **10,959,507 lekë**. Nga të cilat **85%** të vlerës (**95,868.89 euro**) ose **9,315,581 lekë** do të financohet nga donatori (BE) ndërsa **15%** e tij (**16,918.04 euro**) do të jetë bashkëfinancim i bashkisë, e konvertuar në lek në shumën **1,643,926 lekë**, nga të cilat 1,542,584 lekë kontribut në natyrë (in kind) me staf ekzistues dhe 101,342 lekë me fondet e veta. Gjithashtu, Bashkia Shkodër do të financojë me fondet e veta vlerën e TVSH-së e cila nuk njihet si shpenzim nga donatori, shuma **626,258 lekë**, duke arritur në këtë mënyrë buxhetin total të projektit në vlerën **11,585,765 lekë**, sipas tabelës së mëposhtme:

Buxheti total në lekë

Shpenzimet e llogaritura						
	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të patrupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2025	1,123,755	796,414	133,001	194,340		
Shuma 2026	3,310,296	2,670,056	445,900	194,340		
Shuma 2027	6,523,151	2,702,896	451,384	570,375		
Shuma 2028	628,563	538,614	89,949			2,798,496
Shuma totale e Projektit	11,585,765	6,707,980	1,120,234	959,055		2,798,496

Buxheti me burim financimi donacion në lekë

Shpenzimet e llogaritura						
	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të patrupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2025	790,513	538,614	89,949	161,950		
Shuma 2026	2,676,202	2,154,456	359,796	161,950		
Shuma 2027	5,220,303	2,154,456	359,796	373,971		
Shuma 2028	628,563	538,614	89,949			2,332,080
Shuma totale Financim nga donatori	9,315,581	5,386,140	899,490	697,871		2,332,080

Bashkëfinancimi me staf ekzistues në lekë

Shpenzimet e llogaritura						
	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të patrupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2025	300,852	257,800	43,052			
Shuma 2026	601,704	515,600	86,104			
Shuma 2027	640,028	548,440	91,588			
Shuma 2028	0	0	0			
Shuma totale e Bashkëfinancimit (staf)	1,542,584	1,321,840	220,744			

**Stafi i brendshëm i bashkisë i angazhuar në implementimin e projektit do të punojë me kohë të pjesshme në varësi të nevojave dhe Planit të Aktiviteteve të projektit.*

**Bashkëfinancimi me burim financimi fondet e veta në lekë
(Shpenzime për TVSH dhe shpenzime operative)**

Shpenzimet e llogaritura						
	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të patrupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2025	32,390			32,390		
Shuma 2026	32,390			32,390		
Shuma 2027	662,820			196,404		466,416
Shuma 2028	0			0		0
Shuma totale e Bashkëfinancimit me fondet e veta	727,600			261,184		466,416

- Bashkëfinancimi me fondet e veta, me vlerë 727,600 lekë do të alokohet në programin **AB141: Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile**, nga të cilat 261,184 lekë për shpenzime operative dhe 466,416 lekë për shpenzime kapitale të trupëzuara. Burimi i financimit do të jetë nga fondi rezervë për shpenzimet e vitit 2025 (32,390 lekë); ndersa për shpenzimet me fondet e veta në vitet 2026-2027 duhet të parashikohen në fazën finale të PBA 2026-2028.
- Miratimin e numrit të punonjësve dhe fondeve me vlerë 6,285,630 lekë për 2 (dy) punonjësit e planifikuar, me fondet e projektit për vitin 2025 – 2028, për pozicionin e një menaxher projekti dhe një specialist të emergjencave civile. Fondi i përlllogaritur është marrë nga buxheti i projektit dhe shpenzimet mbulohen nga donatori.

Emertimi	Punonjës	I zgjedhur, I emëruar	Arsim i lartë		Arsim i mesëm	
			Kategori	Pozicion	Klasa	Paga mujore
Menaxher projekti	1		III-2			
Specialist i emergjencave civile	1		IV-2			

5. Punonjësit do të punojnë me kohë të pjesshme përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

Zv. Kryetar

Alban Preka

Drejtorja e Përgjithshme Juridike, Burimeve
Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

G. Dama

Drejtorja Burimeve Njerëzore dhe
Shërbimeve Mbështetëse

Anelita Pirej

Drejtorja e Përgjithshme e Menaxhimit
Financiar

ELVIN BRAHIMI

Drejtorja e Analizës dhe Programimit
Buxhetor

Geeta Hoxha

Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të
Qendrueshëm Ekonomik

Behlman Mamo

Drejtorja Juridike

B. Deepa

Drejtorja e Emergjencave Civile

Xhelmet Dini

Drejtorja e Financës

Ilirida Myrda

Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe
Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Sela Chardusha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QENDRUESHËM EKONOMIK
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

Nr _____ prot.

Shkodër, me _____._____.2025

RELACION

“Për miratim shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr. 76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar”.

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Shkodër është shpallur fituese e projektit “SA-0300305/Territory” në kuadër të Instrumentit për Asistencë të Para-Anëtarësisimit (IPA III) Interreg IPA Adriatiku Jugor 2021/2027.

Programi synon të promovojë rritjen ekonomike dhe të intensifikojë bashkëpunimin në zonën e Adriatikut Jugor, përmes zbatimit të veprimeve të përbashkëta ndërmjet aktorëve kombëtarë, rajonalë dhe jofitimprurës. Projekti “Territory” kontribuon në realizimin e Qëllimit Specifik 2.1 – Rreziqet, i cili ka në fokus përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimin e rreziqeve dhe rritjen e qëndrueshmërisë ndaj fatkeqësive, në përputhje me prioritetet e programit.

Projektvendimi i propozuar për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Bashkiak ka për qëllim miratimin e shtesës së fondeve të buxhetit të Bashkisë së Shkodrës për projektin Territori në kuadër të programit Interreg IPA Adriatiku Jugor 2021/2027 (IPA III); Marrëveshjes së Partneritetit datë 20/08/2025, të lidhur ndërmjet Distretto Tecnologico Aerospaziale s.c.a.r.l. në cilësinë e Partnerit Kryesor dhe Bashkisë Shkodër në cilësinë e partnerit.

Projekti Territori ka për qëllim forcimin e kapaciteteve për menaxhimin e fatkeqësive në rajonin e Adriatikut Jugor (Itali, Shqipëri, Mal i Zi), përmes një sistemi inovativ dhe të qëndrueshëm që kombinon teknologjinë e dronëve (UAS) dhe Inteligjencën Artificiale (IA). Duke përdorur këto teknologji, projekti synon:

- përmirësimin e menaxhimit të rreziqeve mjedisore dhe reagimit në situata emergjente,
- analizën dhe përpunimin e të dhënave në kohë reale për vendimmarrje më të shpejtë e efikase,
- lehtësimin e monitorimit të terreneve të vështira dhe zbulimin e hershëm të rreziqeve,
- mbështetjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit.

Një element kyç i projektit është krijimi i një sistemi prototip për zbatim praktik dhe zhvillim të mëtejshëm teknologjik, si dhe trajnimi i stafit për rritjen e aftësive operacionale. Po ashtu, projekti përfshin iniciativa edukative në shkolla dhe universitete, me synimin për të rritur ndërgjegjësimin e të rinjve mbi përgatitjen ndaj fatkeqësive natyrore dhe ndryshimeve klimatike.

Përtej aspektit teknologjik, projekti Territory synon të ndërtojë një rrjet të qëndrueshëm profesionistësh në menaxhimin e fatkeqësive, duke nxitur bashkëpunimin ndërkufitar dhe ndarjen e njohurive në nivel lokal e rajonal. Ky rrjet do të lehtësojë harmonizimin e strategjive të reagimit ndaj rreziqeve dhe do të forcojë kapacitetet për përgatitje dhe ndërhyrje efektive. Projekti do të mbështetet në njohuri ekzistuese, të dhëna historike, dhe angazhimin e palëve të interesuara për të krijuar një sistem gjithëpërfshirës menaxhimi, duke integruar teknologjinë e dronëve dhe vlerësimet e kapaciteteve në skenarë të parashikuar reagimi. Kjo qasje do të mundësojë ndërhyrje të shpejta dhe të targetuara në Itali (Puglia, Molise), Shqipëri dhe Mal të Zi, duke siguruar reagim të koordinuar dhe efikas ndaj fatkeqësive.

Projekti Territory do të ofrojë një sistem të integruar që përfshin:

- Parandalimin dhe monitorimin e përmbytjeve dhe zjarreve;
- Monitorimin mjedisor në zona të vështira për t'u arritur;
- Përdorimin e Inteligjencës Artificiale (IA) për përpunimin dhe analizën e të dhënave, duke përmirësuar ndjeshëm vendimmarrjen në situata emergjente.

Produktet Kryesore:

- Mundësimi i blerjes së dronëve dhe konfigurimi i tyre.
- Një sistem prototip kontrolli të UAS (Qendra e Komandës Territori).
- Një strategji për të integruar teknologjitë e UAS dhe IA për menaxhimin e riskut.
- Raport mbi gjendjen aktuale të zonave referuese për menaxhimin e riskut dhe planin e zhvillimit.
- Një plan për të ndërtuar njohuri dhe kapacitete rajonale.
- Trajnime për autoritetet lokale dhe agjencitë përgjegjëse (me pjesëmarrjen e 15 vetave) për të siguruar përdorimin efektiv të teknologjive të reja.
- Identifikimi i të paktën një vend pilot midis zonave referuese dhe përcaktimi i të paktën një skenari operativ.
- Një rrjet bashkëpunimi ndërkufitar efikas për ndarjen e njohurive mes tre vendeve për përballimin e rreziqeve të përbashkëta.
- Një event në Shkodër dhe 3 të tjerë për secilin partner si Taranto (Itali), Bar (Mali i Zi), Pescolanciano (Itali).
- Një seminar ndërkombëtar tre-ditor.
- Një publikim akademik.

Marrin pjesë në projekt 6 partnerë, Bashkia Shkodër, Distretto Tecnologico Aerospaziale s.c. a r.l. Itali, Instituti për Kërkim dhe Zhvillim Barleti, Luka Bar Mali i Zi, Autoriteti i Sistemit Portual të Detit Jon, Itali, Komuna Pescolanciano, Itali. Referuar kushteve të programit të (IPA III) Interreg IPA Adriatiku Jugor 2021/2027, Bashkia Shkodër angazhohet të zbatojë projektin sipas manualeve dhe udhëzimeve të nxjerra nga Programi lidhur me këtë kontratë, si dhe legjislacionit në fuqi.

Kohëzgjatja e projektit do të jetë 30 muaj nga data e nënshkrimit nga të gjithë partnerët. Bashkia Shkodër është partnere e projektit me një buxhet të dedikuar prej **112,786.94 € (10,959,507 lekë)**, i konvertuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë të datës 20.08.2025, 97.17 EUR. I shpërndarë si më poshtë:

- **95,868.89 € (9,315,581 lekë)** – **85%** financim nga BE (IPA III CBC).
- **16,918.04 € (1,643,926 lekë)** – **15%** bashkëfinancim nga Bashkia Shkodër, nga të cilat 1,542,584 lekë kontribut në natyrë (in kind) me staf ekzistues dhe 101,342 lekë me fondet e veta për shpenzime operative.
- Gjithashtu, Bashkia Shkodër do të financojë me fondet e veta vlerën e **TVSH-së** e cila nuk njihet si shpenzim nga donatori, shuma **626,258 lekë**, duke arritur në këtë mënyrë buxhetin total të projektit në vlerën **11,585,765 lekë**.

Bashkëfinancimi me fondet e veta, me vlerë 727,600 lekë do të alokohet në programin **AB141: Siguria publike dhe Mbrojtja civile**, nga të cilat 261,184 lekë për shpenzime operative dhe 466,416 lekë për shpenzime kapitale të trupëzuara, me burim financimi nga fondi rezervë për shpenzimet e vitit 2025 (32,390 lekë). Ndërsa për shpenzimet me fondet e veta në vitet 2026-2027 duhet të parashikohen në fazën finale të PBA 2026-2028.

Vlera do të transferohet për llogari të Bashkisë Shkodër sipas Udhëzimit nr. 10, datë 12.7.2024 “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare”. Projekti do të zbatohet me llogari me thesar të plotë dhe do të përfshihet në programin P.AB141: Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile, sipas detajimit:

Buxheti total në lekë

Shpenzimet e llogaritura						
	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të trupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2025	1,123,755	796,414	133,001	194,340		
Shuma 2026	3,310,296	2,670,056	445,900	194,340		
Shuma 2027	6,523,151	2,702,896	451,384	570,375		2,798,496
Shuma 2028	628,563	538,614	89,949			
Shuma totale e Projektit	11,585,765	6,707,980	1,120,234	959,055		2,798,496

Buxheti me burim financimi donacion në lekë**Shpenzimet e llogaritura**

	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të trupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2025	790,513	538,614	89,949	161,950		
Shuma 2026	2,676,202	2,154,456	359,796	161,950		
Shuma 2027	5,220,303	2,154,456	359,796	373,971		2,332,080
Shuma 2028	628,563	538,614	89,949			
Shuma totale Financim nga donatori	9,315,581	5,386,140	899,490	697,871		2,332,080

Bashkëfinancimi me staf ekzistues në lekë**Shpenzimet e llogaritura**

	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të trupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2025	300,852	257,800	43,052			
Shuma 2026	601,704	515,600	86,104			
Shuma 2027	640,028	548,440	91,588			
Shuma 2028	0	0	0			
Shuma totale e Bashkëfinancimit (staf)	1,542,584	1,321,840	220,744			

**Stafi i brendshëm i bashkisë i angazhuar në implementimin e projektit do të punojë me kohë të pjesshme në varësi të nevojave dhe Planit të Aktiviteteve të projektit.*

Bashkëfinancimi me burim financimi fondet e veta në lekë (Shpenzime për TVSH dhe shpenzime operative)**Shpenzimet e llogaritura**

	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të trupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2025	32,390			32,390		
Shuma 2026	32,390			32,390		
Shuma 2027	662,820			196,404		466,416
Shuma 2028	0			0		0
Shuma totale e Bashkëfinancimit	727,600			261,184		466,416

me fondet e veta						
------------------	--	--	--	--	--	--

Miratimin e numrit të punonjësve dhe fondeve me vlerë 6,285,630 lekë për 2 (dy) punonjës të planifikuar, me fondet e projektit për vitin 2025 – 2028, për pozicionin e një menaxher projekti dhe një specialist të emergjencave civile. Fondi i përlogaritur është marrë nga buxheti i projektit dhe shpenzimet mbulohen nga donatori. Punonjësit do të punojnë me kohë të pjesshme përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

Emertimi	Punonjës	I zgjedhur, I emëruar	Arsim i lartë		Arsim i mesëm	
			Kategori	Pozicion	Klasa	Paga mujore
Menaxher projekti	1		III-2			
Specialist i emergjencave civile	1		IV-2			

Vlerësojmë të rëndësishme të nënvizojmë që Bashkia Shkodër do të ndjekë të gjitha procedurat për rimbursimin e vlerës së TVSH pranë SASPAC – Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.

Sa mësipër, kërkohet miratimi i shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Shkodër, në programin P.AB141: Siguria Publike dhe Mbrojtja civile.

K R Y E T A R

Benet Beci

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik


Belum Nene

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Stela Mardusha

Drejtoria e Emergjencave Civile

Xhelil Dani



Nr...	P.AB141.Q.2O.1.A.7 Projekti Territory	Programi AB141: Siguria publike dhe Mbrojtja civile
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
i. Situata		
Bashkia Shkodër është shpallur fituese e projektit “SA-0300305/TERRITORY” në kuadër të Instrumentit për Asistencë të Para-Anëtarësimit (IPA III) Interreg IPA Adriatiku Jugor 2021/2027. Qëllimi kryesor i projektit TERRITORY është të forcojë kapacitetet për menaxhimin e fatkeqësive nëpërmjet zbatimit të një sistemi të qëndrueshëm dhe inovativ të bazuar në dronë dhe inteligjencë artificiale. Projekti Territory synon të përmirësojë menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në rajonin e Adriatikut Jugor (Itali, Shqipëri, Mal i Zi) përmes teknologjisë inovative dhe inteligjencës artificiale (IA). Rajonet përfituese karakterizohen nga një diversitet i lartë gjeografik dhe një ndjeshmëri të shtuar ndaj rreziqeve natyrore të përqësuar nga ndryshimet klimatike, si përmbytjet, zjarret në natyrë dhe emergjencat e tjera mjedisore. Këto rreziqe përbëjnë një kërcënim në rritje për jetën, infrastrukturën dhe ekosistemet lokale, prandaj kërkojnë zgjidhje të reja për parandalim, monitorim dhe reagim efektiv. Projekti Territory do të vlerësojë rolin e teknologjiave UAS (Sisteme Ajrore Pa Pilot) dhe Inteligjencës Artificiale (IA) në menaxhimin e rreziqeve mjedisore, të cilat përbëjnë sfida të përbashkëta për partnerët në Itali, Shqipëri dhe Mal të Zi. Duke kombinuar Sistemet Ajrore Pa Pilot (UAS) me Inteligjencën Artificiale (IA), projekti mundëson vendimmarrje më të shpejtë dhe më smart në raste emergjencash, duke përdorur përpunimin dhe analizën e të dhënave në kohë reale. Kjo qasje lejon përgjigje më efikase dhe të sakta, veçanërisht në zona të rrezikshme ose të vështira për t'u aksesuar. Përtej aspektit teknologjik, Territory do të kontribuojë në ndërtimin e një rrjeti të qëndrueshëm të profesionistëve të menaxhimit të fatkeqësive, të përfshirë në nivel lokal dhe rajonal. Ky rrjet do të lehtësojë përafrimin e strategjive për menaxhimin e rreziqeve përtej kufijve kombëtarë, duke siguruar bashkëpunim të vazhdueshëm, ndarje njohurish dhe përmirësim të qëndrueshëm të përgatitjes dhe reagimit ndaj fatkeqësive. Kohëzgjatja e projektit do të jetë 30 muaj nga data e nënshkrimit nga të gjithë partnerët. Vlera e buxhetit për Bashkinë Shkodër është 112,786.94 € euro, e konvertuar në lekë në shumën 10,959,507 lekë. Vlera do të transferohet për llogari të Bashkisë Shkodër sipas Udhëzimit nr. 10, datë 12.7.2024 “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”. Granti do të mbulojë 85% të vlerës totale të projektit, në shumën prej 95,868.89 euro (9,315,581 lekë), ndërsa 15% e mbetur, përbën bashkëfinancimin nga Bashkia Shkodër, në shumën prej 16,918.04 euro (1,643,926 lekë). Konvertimi në lekë është bërë sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, 97.17 EUR, në datën 20.08.2025, datë e cila përkon me nënshkrimin e Marrëveshjes së Partneritetit nga Bashkia Shkodër. Vlera e TVSH-së është shpenzim që nuk mbulohet me fondet e Bashkimit Evropian. Kjo vlerë do të financohet nga buxheti i Bashkisë Shkodër me fondet e veta.		
ii. Synimi i projektit		
Qëllimi kryesor i projektit Territory është të forcojë kapacitetet për menaxhimin e fatkeqësive nëpërmjet zbatimit të një sistemi të qëndrueshëm dhe inovativ të bazuar në dronë dhe inteligjencë artificiale.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
1. Vlerësimi i nevojave të vendeve partnere në Puglia dhe Molise në Itali, Shqipëri dhe Mal të Zi. 2. Organizimi i 4 puntorive me autoritetet lokale, agjencitë, eksperte të fushës. 3. Forcimi i kapaciteteve të partnerëve të projektit në menaxhimin e fatkeqësive përmes vlerësimit të përgjithshëm të burimeve dhe proceseve dhe hartimit të zgjidhjeve smart. 4. Përgatitja për trajnimin e shërbimeve të dronëve. 5. Transferimi i njohurive. 6. Hartimi i një skenari pilot, arkitektura e sistemit dhe shërbimit. 7. Implementimi dhe vendosja e sistemit të Platformës së Droneve Territory. 8. Realizimi dhe shfrytëzimi i pilotit. 9. Blerja e dronëve dhe lidhja e tyre me platformën e Territory.		

Rezultatet:

- ✓ Zhvillimi dhe testimi i zgjidhjeve të bazuara në dronë për situata të ndryshme fatkeqësish.
- ✓ Integrimi i teknologjisë me strategjitë ekzistuese të menaxhimit të emergjencave.
- ✓ Zhvillimi i planeve të veprimit për përdorimin e dronëve në përgatitje dhe reagim ndaj fatkeqësive.
- ✓ Trajnime për autoritetet lokale dhe agjencitë përgjegjëse, për të siguruar përdorim efektiv të teknologjive të reja.
- ✓ Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndarja e njohurive mes tre vendeve për përballimin e rreziqeve të përbashkëta.

c)Aktorët e mundshëm

- ✓ Bashkia Shkodër
- ✓ Drejtoria e Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi MZSH
- ✓ Partnerët e projektit Territori

d)Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkodër
Programi IPA Itali-Shqipëri-Mali i Zi (Adriatiku Jugor)"

e) Shpenzimet e llogaritura

			Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferi	Kapitale
A.1	Paga dhe sigurime (bashkëfinancim)	300,852	257,800	43,052			
A.2	Paga dhe sigurime (donatori)	628,563	538,614	89,949			
A.3	Shpenzime për udhëtim dhe akomodim (donatori)	161,950			161,950		
A.4	Përbushja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga marrëveshja e grantit (tvsh fondet e bashkisë)	32,390			32,390		
Shuma 2025		1,123,755	796,414	133,001	194,340		
			Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferi	Kapitale
A.1	Paga dhe sigurime (bashkëfinancim)	601,704	515,600	86,104			
A.2	Paga dhe sigurime (donatori)	2,514,252	2,154,456	359,796			
A.3	Shpenzime për udhëtim dhe akomodim (donatori)	161,950			161,950		
A.4	Përbushja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga marrëveshja e grantit (tvsh fondet e bashkisë)	32,390			32,390		
Shuma 2026		3,310,296	2,670,056	445,900	194,340		
			Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferi	Kapitale
A.1	Paga dhe sigurime (bashkëfinancim)	640,028	548,440	91,588			
A.2	Paga dhe sigurime (donatori)	2,514,252	2,154,456	359,796			
A.3	Shpenzime për udhëtim dhe akomodim (donatori)	161,950			161,950		
A.4	Blerje dron për kontroll permbytjesh, zjarresh (donatori)	2,332,080					2,332,080
A.5	Organizimi i një workshop në Shkodër (donatori)	212,021			212,021		
A.5.1	Organizimi i një workshop (fondet e bashkisë)	101,342			101,342		

A.6	Përbushja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga marrëveshja e grantit (tvsh fondet e bashkisë)	561,478			95,062		466,416
	Shuma 2027	6,523,151	2,702,896	451,384	570,375		2,798,496
	Shpenzimet për çdo aktivitet 2028	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga dhe sigurime (donatori)	628,563	538,614	89,949			
	Shuma 2028	628,563	538,614	89,949			
f) Periudha e zbatimit 2025, 2026, 2027, 2028		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Emergjencave Civile Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër					